




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep.  
 Dep. 2-D/DPK  
 Nr.faq.  
 Broj stranica  
 Nr. pages 02

Nr Prot.  
 Br Prot.  
 Prot No. 01-2575/14  
 Data  
 Datum  
 Date 11.07.2014

PRISHTINE



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

<b>DATË/A:</b>	09/07/2014
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK-DPK- DPKPP
<b>PËR/ZA/TO:</b>	z. Fadil ABAZI Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Vitisë
<b>CC:</b>	z. Sokol HALITI Kryetar i Komunës së Vitisë
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinion lidhur me tenderin: Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza në vërban



I nderuari z. ABAZI,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza në vërban me numër prokurimi: VI657-14-033-521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

**OPINION**

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin: Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza në vërban me numër prokurimi: VI657-14-033-521 në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

## A r s y e t i m

Komuna e Vitisë, si Autoritet Kontraktues ka përgatitur “Njoftimin për Kontratë” me titull: “Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza në vërban” me numër të prokurimit:VI657-14-033-521. Ky aktivitet prokurimi më datë:17/06/2014 është publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik. Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet Prokurimi si rast për trajtim dhe gjatë ekzaminimit të këtij aktiviteti nga “Dosja e Tenderit”, Agjencia ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me Procedurat e Prokurimit në Kosovë.

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD), tek Kërkesat e përshtatshmërisë Profesionale, pika 7.2, nënpika 2, thuhet: *Bartësi kryesor i konzorciumit lideri, duhet të plotësoj 60 % të kriterëve ekonomike-financiare-teknike dhe profesionale.* Kërkesat që kanë të bëjnë me Gjendjen Ekonomike dhe Financiare, si dhe Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale duhet të plotësohen nga Grupi i Operatorëve në tërësi, e jo nga secili Operator Ekonomik veç e veç, siç është kërkuar në “Dosja e Tenderit”. Autoriteti Kontraktues gjithashtu nuk ka të drejtë të përcaktojë Operatorit Ekonomik përqindjen se sa për qind mund ta plotësoj njëri tjetrin.

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD), tek Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare pika 8.1 nënpika 1, thuhet: *Vlera e përgjithshme monetare e punëve të ekzekutuara në lëmin e kanalizimeve dhe të ngjashme, për operatorin ekonomik ose grupin e operatorëve ekonomik të jetë në vlerë prej 400.000.00 €.* Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj qarkullim financiar për tre vitet e fundit shumë të caktuar, e cila nuk duhet të kaloj dy herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit; Nenin 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042; si dhe Neni 5, Gjendja Ekonomike dhe Financiare i UA-02/2014.

Agjencia Kundër Korrupsion konsideron se praktika të tilla nuk duhet lejuar, andaj rekomandon anulimin e këtij aktiviteti, duke mos i përsëritur praktikat e ngjashme në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!

